

SI TA MBRONI PRIVATËSINË NË YouTube?

Youtube.com është ueb-faqja më e njohur për shpërndajrë të video-përmbajtjeve.

- ▶ Mbi 800 milionë shfrytëzues e vizitojnë Youtube-in për çdo muaj.
- ▶ Mbi 3 miliardë orë video në muaj shihen në Youtube.
- ▶ Gjithsej 72 orë video futet në Youtube për çdo minutë.




Kur publikoni në Youtube, duhet ta keni parasysh fuqinë e shpërndarjes dhe të përcjelljes së informatës që e ka ky shërbim. Vetëm disa sekonda pas publikimit të video-përmbajtjes suaj, atë mund ta shohin një numër shumë i madh shfrytëzuesish. Para se të publikoni, mendoni për ndikimin që mund ta shkaktojë një veprim i tillë. Ndonjëherë edhe një video e publikuar si shaka, mund të marrë mbrapsht, sepse pasi të publikohet nuk ka mënyrë që t'i pengoni shfrytëzuesit tjerë që ta marrin atë.

Parametrat për privatësi në Youtube mund t'u ndihmojnë ta mbronin identitetin tuaj dhe të ruani një imazh pozitiv kur përbashkoni video onlajn me të tjerët. Me përshtatjen e parametrave për privatësi në profilin tuaj, përzgjedhjen e kujdesshme të përmbajtjeve të videove tuaja dhe kontrollimin e interaksioneve onlajn mund ta mbronin veten dhe privatësinë tuaj.

RUANI PRIVATËSINË E VIDEOVE TUAJA

Mund të zgjidhni që videot tuaja në Youtube t'i përbashkoni me botën (**Public**) ose t'i bëni private (**Private**), me çka do ta kufizoni publikun në 50 vizitorë që ju do t'i ftoni ta shohin video-përmbajtjen tuaj. Në qoftë se dëshironi t'i përbashkoni videot tuaja me më shumë se 50 njerëz ose me miq të cilët nuk kanë profil në Youtube, atëherë vendosni videot tuaja si "të palistuar" (**Unlisted**). Çdokush nëpërmjet ueb-adresës do të mund ta shohë videon, por pa adresë. Videot e "palistuar" nuk mund të gjenden. Ato nuk paraqiten te rezultatet e kërkimit, as në kanalet e Youtube-it dhe as kudoqoftë në ueb-faqe.

Zgjedhjen e privatësisë së videove tuaja mund ta bëni gjatë futjes së tyre në Youtube. Në qoftë se dëshironi t'i ndryshoni parametrat e videos që e keni futur më parë, atë mund ta bëni nëpërmjet menysë suaj të shfrytëzuesit, e cila gjendet në këndin e djathtë të epërm dhe është e shënuar me emrin tuaj të shfrytëzuesit. Nga menyja rënëse zgjidhni opcionin **Video Manager** dhe pastaj klikoni butonin **Edit** që gjendet nën çdo video të vendosur në Youtube. Në pjesën **Privacy Settings** keni mundësi ta bëni ndryshimin e privatësisë që dëshironi.



SHIHNI PËRMBAJTJEN E VIDEOVE TUAJA

Shumë lehtë dhe padashur mund të përbashkoni të dhëna personale në ndonjë video, p. sh.: ku jetoni, si duket brendësia e shtëpisë suaj, cila është familja juaj ose informata të këtilla të ngjashme për miqtë tuaj. Prandaj, kini kujdes gjatë publikimit

të përmbajtjeve në Youtube që mund të zbulojnë informata të cilat nuk dëshironi t'i përbashkoni me vetëdije me të tjerët.

PËRSHTATNI PARAMETRAT PËR PRIVATËSI NË PROFILIN TUAJ

Jo gjithmonë duam që aktivitetet tona të jenë të dukshme për të gjithë, edhe pse në mënyrë të pavetëdijshme e lejojmë shpesh një gjë të tillë për shkak se nuk i kemi përshtatur parametrat për privatësi në profilet tona onlajn. Në qoftë se dëshironi që aktivitetin tuaj në Youtube ta fshihni nga personat e panjohur, duhet t'u kushtoni kujdes parametrave për privatësi.

Këta parametra ju mundësojnë **1** kontroll mbi atë se kush mund t'ju dërgojë porosi; **2** të përcaktoni se a lejoni që njerëzit që e kanë adresën tuaj të e-mail-it të mund ta gjejnë kanalin tuaj në Youtube; **3** të lejoni që informatat tuaja të shfrytëzohen për reklama të përpiluara sipas interesit tuaj dhe **4** të defnioni a do të jenë të dukshme publikisht

statistika dhe të dhënat për videot tuaja.

The screenshot shows the 'Account settings' page for a YouTube channel, specifically the 'Privacy' section. The page is divided into several tabs: Overview, Sharing, Privacy, Email, and Playback. The 'Privacy' tab is selected and highlighted. Under the 'Privacy' tab, there are three main sections: 'Search and contacts', 'Ads based on my interest', and 'Statistics and data'. Each section has a checkbox and a label. The 'Search and contacts' section has two checkboxes: 'Allow only my contacts to send me messages and share videos' (checked) and 'Let people find my channel on YouTube if they have my email address' (unchecked). The 'Ads based on my interest' section has one checkbox: 'Use my information to provide me with relevant advertising' (unchecked). The 'Statistics and data' section has one checkbox: 'Make statistics and data for my videos publicly visible by default' (unchecked). There are four red circles with white numbers (1, 2, 3, 4) overlaid on the checkboxes to indicate the steps mentioned in the text. A 'Save' button is visible in the top right corner of the settings area.

Në qoftë se jeni të lajmëruar në shërbimin Youtube, këto opsione i keni në dispozicion në pjesën **Privacy**, të cilën do ta gjeni pasi ta zgjidhni opcionin **Settings**, në listën rënëse nga menyuja juaj e shfrytëzuesit, në këndin e djathtë të epërm.

KONTROLLONI KOMENTET, VLERËSIMET DHE PËRGJIGJET

Ky shërbim mundëson t'i përbashkoni videot tuaja me një publik të madh, ku ndonjëherë mund të ketë edhe njerëz të pandershëm, të cilët publikojnë materiale ofenduese në ueb. Pasojat nga sjellja e keqe dhe keqpërdorimi i përmbytjeve të publikuara nga ana e shfrytëzuesve të tjerë mund të jenë shumë serioze. Kështu është rasti me të gjitha rrjetet sociale ku çdoherë nuk i njohim personalisht të gjithë miqtë me të cilët jemi të lidhur në rrjet.

Prandaj pëshatni parametrat që të përcaktoni se **1** kush mund t'i komentojë videot tuaja; **2** a mund të votojnë shfrytëzuesit; **3** a mund t'i shohin vlerësimet e videove tuaja dhe **4** kush mund të japë përgjigje? Në këtë mënyrë mund të pamundësoni publikimin e komenteve të pahijshme, të refuzoni përpjekjet e sërishme të komentuesve për të komentuar dhe të pengoni sajberdhunën.

Këto kushte mund t'i rregulloni duke zgjedhur **Video Manager** në menynë e shfrytëzuesit dhe pastaj opcionin **Edit** që gjendet nën çdo video të vendosur, në tab-in **Advanced Settings**. Këtu, në pjesën **Syndication** mund t'i zgjedhni edhe **5** a do të lejoni që përmbytjet tuaja të shihen në celularë dhe në pajisje të tjera.

KINI KUJDES SE KU JANË TË DUKSHME VIDEOT TUAJA

Videot e Youtube-it përhapen shumë më larg se sa ueb-faqja e këtij shërbimi dhe kompjuteri juaj. Youtube, sikurse edhe shumë shërbime të tjera, ofron mundësi që përmbytjet e futura në të, të shkarkohen dhe të vendosen në ndonjë ueb-faqe ose blog tjetër. Nëse futni ndonjë përmbytje dhe pastaj e fshini, kjo nuk është garancë se ajo më nuk ekziston në internet. Për disa sekonda videoja mund të shkarkohet nga dikush tjetër dhe të publikohet sërish.

Basic Info Advanced Settings

Comments and responses

1 Allow comments: All

2 Users can vote on comments

3 Users can view ratings for this video

4 Allow video responses: Approved

Syndication

5 Yes, make this video available on mobile phones and TV Note, the video may not be available on all devices due to copyright or licensing issues

No, this video should not be available on mobile phones and TV

Embedding

6 Enable Embedding ?

Video location

Recording date

3D Video

No preference

Që të mbroheni nga mundësia që dikush ta shkarkojë përmbajtjen tuaj dhe ta vendosë në profilin, ueb-faqen, blogun ose mediumin e tij, e njëkohësisht edhe t'i mbronit të drejtat tuaja autoriale, duhet ta ndaloni ngulitjen (embed) e videos suaj, ku duhet **6** ta çkyçni opcionin **Enable Embedding** në **Advanced Settings**.



PËRCAKTONI SE SA DO TË JENË TË DUKSHME AKTIVITETET TUAJA NË YOUTUBE

Profili në Youtube ju mundëson që aktiviteti juaj në këtë shërbim të jetë i dukshëm për të tjerët. Në qoftë se jeni të brengosur për privatësinë, atëherë më mirë është që të tjerëve të mos u lejoni të shohin se çka bëni.

Për shembull, shërbimi mundëson që komentet që i kenë lënë ju në videot e të tjerëve të jenë të dukshme për shfrytëzuesit e tjerë, por ndonjëherë nuk jemi të vetëdijshëm se sa njerëz, përveç atyre për të cilët ka qenë i dedikuar komenti, mund ta shohin atë. Prandaj, duke zgjedhur opcionin **My Channel** nga lista rënëse e menysë suaj të shfrytëzuesit, e pastaj **Channel settings** dhe më pas **Tabs**, mund të rregullohet dukshmëria e veprimeve tuaja për njerëzit tjerë.

The screenshot shows the 'Channel Settings' page for a YouTube channel, specifically the 'Feed' tab. The page is divided into sections: 'Appearance', 'Settings', and 'Tabs'. Under 'Settings', there is a 'Default Tab' dropdown set to 'Feed Tab' and a checked checkbox for 'Always take subscribed users to the feed tab'. The 'Feed' section is expanded, showing a 'Featured' checkbox (unchecked) and a section titled 'Activity you will share'. Below this, there is a list of activities with checkboxes: 'Like a video', 'Comment on a video', 'Favorite a video', and 'Subscribe to a channel'. All these checkboxes are checked. Below the activity list is the 'Feed settings' section, which includes a checked checkbox for 'Allow channel comments' and two radio buttons: 'Display automatically' (selected) and 'Don't display until approved'. Six red circular callouts with white numbers (1-6) are overlaid on the image, pointing to the following elements: 1. 'Activity you will share' section header; 2. 'Like a video' checkbox; 3. 'Comment on a video' checkbox; 4. 'Subscribe to a channel' checkbox; 5. 'Allow channel comments' checkbox; 6. 'Display automatically' radio button.

Mes tjerash, këtu janë parapagimet (**subscriptions**) kur shfrytëzuesit parapagohen të profili i ndonjë shfrytëzuesi tjetër, me qëllim që të jenë në rrjedhë me aktivitetet e tij. Kështu, parapaguesit i përcjellin të gjitha publikimet dhe aktivitetet e shfrytëzuesit të cilat ai i ka vendosur si publike. Prandaj, kini kujdes se çka përbashkoni me të tjerët si publike dhe përcaktoni se a do të jenë të dukshme ose të padukshme në kanale **1** “like”-at; **2** komentet; **3** favoritët ose **4** parapagimet.

Poashtu, mund të caktoni **5** se a lejoni komente në kanalën tuaj dhe në qoftë se lejoni, **6** a duhet komentet të miratohen para se të publikohen, me çka mund të siguroheni se asnjë koment nuk do të kalojë i pavërejtur për ta ditur gjithmonë se çka ndodh në profilin tuaj.

Mirëpo dukshmëria është faktor i rëndësishëm për disa shfrytëzues. Prandaj Youtube-i lejon që ti lidhni profilet tuaja në Twitter ose në Facebook, me qëllim që përbashkimi të jetë sa më i madh. Në qoftë se përcaktoheni për një lidhje të këtillë të llogarive tuaja të shfrytëzuesit, duhet të jeni të vetëdijshëm se, me këtë zgjedhje, publiku që do të ketë qasje deri te informatat që i përbashkoni do të jetë shumë më i madh sepse do ta përfshijë edhe numrin e miqve tuaj në Facebook dhe numrin e atyre që ju ndjekin në Twitter.



Account settings

- Overview
- Sharing**
- Privacy
- Email
- Playback

Sharing

[Save](#)

Connect your accounts


- Orkut [Connect](#)
- Twitter [Connect](#)
- Facebook [Connect](#)

Share your activity

	On YouTube	On connected accounts
Upload a video*	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
Add video to playlist**	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
Favorite a video	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
Like a video	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
Comment on a video	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
Subscribe to a channel	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

* Public video uploads are always shared on YouTube
 ** Add To Playlist events are managed by the privacy settings of individual playlists

Eshtë mirë të keni kontroll mbi mënyrën e përbashkimit dhe sasinë e informatave që i publikoni në Youtube, e poashtu edhe të profileve tjerë që i keni lidhur me të. Megjithatë, mund të zgjidhni se cilat aktivitete do t'i përbashkoni, prandaj, caktoni se për **1** favoritët; **2** "like"-et; **3** komentet dhe **4** parapagimet në kanalet e Youtube-it, a duhet të dijnë edhe shfrytëzuesit e tjerët të Youtube-it dhe **5** miqtë tuaj në rrjetet tjera sociale të cilat i keni lidhur me Youtube-in. Rregulloni këto kufizime nëpërmjet opcionit **Sharing** që gjendet në menynë **Settings** të menysë suaj të shfrytëzuesit.



Youtube, poashtu lejon krijimin e playlist-ave personale nga videot që janë vendosur nga shfrytëzuesit tjerë. Në qoftë se dëshironi ta rregulloni mënyrën se si mund të shfrytëzohen këto lista nga ana e të tjerëve, duhet të klikoni në emrin e playlist-ës dhe të zgjidhni **1** a do të jetë ajo publike ose private; **2** a do të lejoni që të tjerët të mund ta fusin atë në ueb-faqet e tyre dhe **3** të japin vota pozitive ose negative.

KRIJONI FJALËKALIM TË FUQISHËM

Që ta pengoni keqpërdorimin e llogarisë suaj të shfrytëzuesit, krijoni fjalëkalim të fuqishëm të cilin do ta dini vetëm ju. Me fjalëkalim të fuqishëm nënkuptojmë kombinim të mirë të shkronjave, numrave dhe/ose shenjave speciale. Në qoftë se dyshoni se dikush e ka kuptuar fjalëkalimin tuaj, ndryshojeni atë menjëherë.

MOS E LINI PAS DORE HISTORINË E AKTIVITETEVE TUAJA

Në qoftë se kompjuterin tuaj e shfrytëzojnë edhe njerëzit e tjerë, ose lajmëroheni në Youtube nga ndonjë kompjuter publik, ekziston rreziku që aktivitetet tuaja t'i shohin edhe shfrytëzuesit e tjerë në qoftë se harroni të çlajmëroheni. Për këtë arsye, mund ta fshini historinë e videove që i keni parë, kërkimet tuaja në Youtube, videot që i keni caktuar për t'i parë më vonë, favoritët dhe ato të cilat keni shtypur "like".

Te menja juaj e shfrytëzuesit shkoni te **Video Manager** dhe në pjesën **History**, së pari klikoni në **Clear all viewing history** që ta fshini evidencën për atë që e keni parë deri atëherë, e pastaj klikoni në butonin **Pause viewing history** që ta pengoni evidentimin në të ardhmen. Të njëjtën mund ta bëni edhe për të gjitha kërkimet që i keni bërë në Youtube (**Search History**), si dhe t'i largoni ato për të cilat paraprakisht keni caktuar ndonjë aktivitet (**Watch Later, Favorites, Likes**).

The screenshot displays the YouTube interface with the 'History' page selected. The top navigation bar includes 'Video Manager', 'Video Editor', 'Subscriptions', 'Analytics', 'Inbox', and 'Settings'. The left sidebar contains 'Upload', 'Dashboard', 'Uploads', 'Playlists', 'History', 'Search History', 'Watch Later', 'Favorites', and 'Likes'. The main content area shows a list of videos in the History section with controls to 'Add to', 'Remove', 'Clear all viewing history', and 'Pause viewing history'.

Video Thumbnail	Title	Channel	Views	Likes	Comments	Time Ago
	MIKA - Relax, Take It Easy (New Version)	MIKA	6,079,532	21,546	283	2 years ago
	How far will you go for Fantastic Delites? - ...	TasteFantastic	611,796	3,884	75	1 week ago
	Scientific Diving: Invasive Species Research...	usgs	1,591	2	0	1 year ago
	Breakfast Club Interview Michael Ealy	terrancelj1	80,024	395	10	6 months ago
	3D animation motion comic model of Sofia...	TwistedSofia	1,938	21	0	3 years ago


DENONCONI ÇDO SJELLE TË KEQE

Shqetësimi në internet nuk është dukuri e pazakonshme, prandaj askush nuk duhet të jetë viktimë e keqpërdorimit të këtillë. Youtube është një komunitet, kështu që nëse dikush ju shqetëson, nëse e dëmton privatësinë tuaj ose nëse sillet në mënyrë të pahijshme, më mirë është që këtë sjellje ta denonconi. Mos u përgjigjini në komentet qëllimkëqia dhe bllokoni çdo komunikim me këta persona.

Që ta bllokoni ndonjë shfrytëzues në Youtube nga menyja juaj e shfrytëzuesit shkoni në **Inbox** dhe, pasi ta shtoni emrin e tij të shfrytëzuesit në **Address Book**, shtypni butonin **Block**.




Duke e pasur parasysh numrin e madh të shfrytëzuesve në Youtube është e pamundur të kihet kontroll i plotë mbi kualitetin dhe përmbajtjen që publikohet për çdo ditë. Në frymën e komunitetit, në qoftë se hasni në ndonjë video-përmbajtje për të cilën konsideroni se është e papërshtatshme ose e pahijshme, shfrytëzoheni veglën **Flag** që gjendet nën çdo video për ta denoncuar atë.



Në qoftë se përmbajtjet tuaja keqpërdoren në internet dhe vihet në pikëpyetje privatësia juaj, mund ta kontaktoni Drejtorinë për mbrojtjen e të dhënave personale që të informoheni për hapat e ardhshëm që duhet t'i ndërmerrni (dzlq.mk).



Botues: Metamorfozis

METAMORPHOSIS 

Foundation for Internet and Society

**Përkrahur nga: Fondacioni Shoqëri
e hapur – Maqedoni**



Për botuesin: Bardhyl Jashari

Autore të tekstit:

Irina Shumadieva dhe Tamara Resavska

Përktheu: Valon Abdiu

Lekturoi: Fatmir Sulejmani

Përpunimi grafik: Koma

CIP - Katalogizacija vo publikacija
Nacionalna i univerzitetska biblioteka "Св. Климент
Охридски", Скопје

004.738.5.056.5(036)

SHUMADIEVA, Irina

Si ta mbrojmë privatësinë në Youtube? / [Autore të tekstit Irina
Shumadieva dhe Tamara Resavska ; përktheu nga maqedonishtja
Valon Abdiu]. - Shkup : Metamorfozis, 2012. - 12 стр. : илустр. ;
16x16 см

Превод на делото: Како да си ја заштитиме приватноста на Јутјуб?
/ автори Ирина Шумадиева, Тамара Ресавска

ISBN 978-608-4564-45-4

1. Resavska, Tamara [автор]. - I. Šumadieva, Irina види
Shumadieva, Irina

а) Интернет - Безбедност - Водичи
COBISS.MK-ID 92212746